

VENDIM
Nr. 70, datë 29.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 933, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 147/2014, “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, fjalët “... gjithsej, 86 veta ...” zëvendësohen me “... gjithsej, 118 veta ...”.

2. Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Fjalja e parë, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) siguron shërbim, komandim, monitorim, kontroll dhe koordinim të shërbimit kombëtar të urgjencës mjekësore, siguron shërbim dhe mbulon me personel mjekësor edhe Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopter.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE		
	Pozicioni	Nr.
1	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	1
	Specialist	1
2	Drejtoria e Shërbimit të Urgjencave Mjekësore Paraspitalore dhe Njesisë së Koordinimit	[80]
	Drejtor mjekësor	1
	Kryeinfermier urgjence	1
	Mjek (urgjence)	26
	Infermier (urgjence)	35
	Farmacist	1
	Shofer autoambulance	16
3	Drejtoria e Statistikës, Regjistrit të Urgjencës dhe Trajnimeve	[12]
	Drejtor	1
3.1	Spektori i Trajnimeve, Certifikimeve, Akreditimit dhe Promocionit	[7]
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialist (shkenca mjekësore)	3
	Specialist promocioni	2
	Specialist komunikimi	1
3.2	Spektori i Statistikës dhe i Regjistrit të Urgjencës	[4]
	Përgjegjës sektori	1

	Specialist	2
	Operator	1
4	Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit	[24]
	Drejtor	1
4.1	Spektori i financës dhe buxhetit	[6]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (financë/buxhet)	3
	Llogaritar	1
	Specialist investimesh (ekonomist, inxhinier)	1
4.2	Spektori juridik	[4]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist jurist	1
	Specialist prokurimi (jurist/ekonomist/inxhinier)	2
4.3	Spektori i shërbimeve mbështetëse	[13]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (burime njerëzore)	1
	Specialist investimesh (inxhinier)	1
	Specialist biomjekësor	1
	Arkivist	1
	Sanitar	3
	Magaznier	1
	Teknik i mesëm (specialitete të ndryshme)	2
	Punonjës informacioni	2
	Punonjës, gjithsej	118